



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____

Data: _____

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017,
Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

K O N K U R S **Për plotësimin e vendit të punës**

Titulli: Zyrtar/e për PR dhe Marketing 1(një) pozitë

Nr. i referencës:
NPB/DMI/10.11

Niveli pagës: 6

Lloji i Pozitës: Zyrtar/e për PR dhe marketing

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar (puna provuese 6 muaj)

Vendi i punës:Rr.Xhevdet Doda nr.32, Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

I përgjigjet: Udhëheqësit/es të Divizionit për Media

Detyrat e përgjithshme:

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara Udhëheqësi i Divizionit të Mediave;
- Ndihmon Menaxherin dhe bashkëpunon me zyrtarët e tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës, për përmbushjen e objektivave të DKM-se në veçanti dhe NPB në përgjithësi;
- Drejton, bashkëpunon dhe Mbikëqyr ekipën për PR dhe Marketing të NPB-së;
- Krijon gjuhë gjithë përfshirëse për komunikimin e të dhënave rreth punës së NPB dhe palëve të treta.
- Menaxhon dhe krijon kontent origjinal për rrjetet sociale të NPB-së;
- Krijon plan të integruar të marketingut për komunikim dhe promovim të identitetit të ri të NPB;
- Definon kanalet e duhura të komunikimit për promovimin e punës së NPB në mënyrë sa më të denjë dhe më të kuptueshme për audiencën;
- Unifikon të dhënat të cilat komunikohen në mënyrë që të paraqitet një pasqyrë e saktë e punës së NPB në të gjitha palët e interesit;
- Krijon planin e integruar të marketingut dhe PR-it të koordinuar vizualisht me identitetin e ri të NPB-së, së bashku me ekipën kreative profesionale dhe zyrtarët e NPB;
- Menaxhon, konfiguron dhe optimizon rrjetet sociale të NPB-së;
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga Udhëheqësi i Divizionit të Mediave.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Udhëheqësi i Divizionit për Media e ngarkon me detyra tjera sipas nevojës së NPB-së;
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund ta zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera.

Kualifikimet:

- Diplomën e shkollës së mesme;
- Dëshmi për përvojë pune së paku 2 vite në fushën e marketingut/ menaxhimit të rrjeteve sociale.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi kompjuterike të programeve Microsoft Office si dhe në programet për editim të fotove dhe videove, në veçanti në programet ADOBE COLLECTION;
- Të njohë mirë rrjetet sociale (FB, INSTAGRAM, TWITTER, LINKED IN etj.), funksionimin dhe menaxhimin e tyre;
- Të njohë pajisjet/aparatet fotografike dhe vizulele;
- Aftësi të mirë në përdorimin e bazave të të dhënave;
- Në gjendje për të punuar nën presion dhe me orar të zgjatur;
- Njohja e gjuhës Angleze;
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Shkathësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Shkathësi në komunikim, planifikim të punës dhe punës ekipore;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë.

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjera profesionale gjatë karrierës;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë të kryer kurse apo trajnime për fotograf ose dizajn grafik;
- Patent shofer kategoria-B;
- Të ketë njohuri rreth punës dhe mirëmbajtjes së rrjeteve sociale.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesipunesimi/ . Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Xhevdet Doda, nr. 32, Prishtinë, të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionit i duhet bashkëgjitur;

- CV/Resume;
- Formulari për aplikim i NPB-së;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nën hetim (jo më e vjetër se 6 muaj)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 20.05.2021 deri më 03.06.2021

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.